



Imagination  
Ideas Inspiration  
Innovation  
Negotiation  
Networking  
Novelties  
Necessities  
Coordination  
Concepts  
Competences



Nr. 72

Viti i shtatë i botimit

Maj 2019

**Në këtë numër do të gjeni:**

- *Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura*
- *Webinar mbi edukimin dhe gastronominë*
- *Rritja e kapaciteteve lokale për lobim dhe advokaci për mbrojtjen dhe mirëmenaxhimin e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë / nga Agri-en dhe AlbNatura*
- *Nga veprimtaritë e grupimit "Të mbrojmë lumenjtë"*
- *Gjiri i Porto Palermos të shpallet Zonë e Mbrojtur Detare*
- *Mbrojtja e Deltës së lumit Buna*
- *Furnizimi me energji fotovoltaike për tre qendrat e vizitorëve të parqeve kombëtare*
- *Zhvillimi i ekoturizmit të qëndrueshëm duke respektuar mjedisin*
- *Ndikimi në politikat e ruajtjes së natyrës nëpërmjet advokim-lobimit efektiv*
- *Një copëz lagunë vjen në Tiranë / nga REC Shqipëri*
- *Dita e Tokës 22 dhe 23 Prill 2019 / nga Qendra EDEN*
- *Ekonomia e gjelbër / nga Qendra EDEN*
- *Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?*
- *...me këtë rast Ju kujtojmë se...*
- *Pelikani kaçurrel dhe rreziqet që i kanosen*
- *Kuriozitete për peshkaqenët*
- *Njoftime*



PK Shebenik - Jabllanicë © Foto INCA



**Institute for Nature Conservation in Albania**  
**Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri**

## Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura

Në kuadër të projektit ACAP, si dhe bashkëpunimit midis partnerëve të projektit dhe AdZM Vlorë, u zhvillua sot një aktivitet me fokus Zonat e Mbrojtura, Parku Kombëtar Llogara, me studentët e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, Departamenti i Biologjisë. Gjatë këtij aktiviteti u krye mbjellja e fidanëve të Bredhit të Maqedonisë (*Abies borisii-regis*) në zonat e zhveshura nga pemët. Më pas studentët u njohën me Parkun Kombëtar dhe gjithë elementët e tij karakteristikë, informacioni i cili është i pasqyruar edhe në qendrën e Vizitorëve në Llogara. Një nga objektivat kryesore të projektit është Edukimi Mjedisor, prandaj përfshirja e studentëve të fushave mjedisore në aktivitete të tilla, konsiston në rritjen e njohurive mbi llojet e organizmave bimore dhe shtazorë të parkut, për të cilat ata marrin informacione të detajuara. Gjithashtu ndjekja e



"Shtegut të Cezarit", na ofroi mundësinë për t'u njohur me disa nga bimët tipike të parkut si dhe organizma të tjerë shtazorë të dukshëm si shpendët ose të identifikuar nëpërmjet gjurmëve.

Më tre prill nisi puna për vendosjen e koshave plastik per diferencimin e mbetjeve si dhe kompostierave në shkollat target të projektit ACAP, në qytetin e Vlorës (Hasan Mëhilli-Dukat, Balil Pelari-Orikum, Pilo Prifti-Novoselë, Nikolla Xhuvli-Nartë dhe Lef Sallata-Vlorë). Qëllimi i vendosjes së koshave të plastikës, është diferencimi i këtyre mbetjeve në shkollë dhe sigurimi i mbledhjes dhe riciklimit të tyre. Po ashtu,

përdorimi i kompostierës nëpër shkolla drejtpërdrejtë



nga nxënësit, do të ndihmojë në rritjen e njohurive mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve organike dhe dekompozimit të tyre në gjendje natyrore, për të siguruar materialin e nevojshëm organik të përdorshëm për rritjen e bimëve të tjera në ambientet e shkollës.

Në kuadër të projektit ACAP ishim sot me nxënësit e klasave të V-ta të shkollës Lef Sallata në Vlorë për të vazhduar me aktivitetet e edukimit mjedisor me fokus natyrën në mënyrë që nxënësit të kuptojnë edhe më mirë natyrën dhe elementët e saj.



Natyra dhe elementët e saj!  
Nxënësit e klasës së III të shkollës "Balil Pelari", Orikum në kuadër të Projektit ACAP realizuan një orë mjedisore dedikuar natyrës. Kur natyra përmban të gjithë elementët e saj në gjendjen e tyre natyrore dhe të shëndetshme ajo ndodhet në ekuilibër dhe cdo gjë kryen funksionin e saj në mënyrën e duhur. Kur njëri nga *Vijon në faqe 3*

*Vijon nga faqe 2* këta elementë (qoftë edhe të padukshëm për syrin e njeriut) dëmtohet ose zhduket për shkaqe të ndryshme si natyrore ashtu edhe si rezultat i faktorit antropogjen, siç është njeriu, shkëputet prej natyrës duke prishur këtë ekuilibër ekologjik dhe natyra nuk do të jetë më në gjendjen e saj të mëparshme. Prandaj kur themi "Të Mbrojmë Natyrën" duhet të jemi të kujdesshëm me çdo pjesë përbërëse të saj, duke i mbajtur ato në ekuilibër.



Në kuadër të projektit ACAP, INCA në bashkëpunim me AdRZM Berat dhe shkollën 9-vjeçare Riza Yzeiri - Karkanjuz, Berat, organizuan një aktivitet sensibilizues me fokus natyrën.



## Webinar mbi edukimin dhe gastronominë

**Vlorë - 17 Prill 2019** - Në kuadër të projektit NEMO u zhvillua webinar i me temë "Webinar mbi edukimin dhe gastronominë në mënyrë që të inkurajojmë fëmijët e shkollës fillore të ushqehen me peshq". Gjatë këtij webinari morrën pjesë përfaqësues të vendeve të Mesdheut, partner të projektit Nemo, si Tunizia, Shqipëria, Algjeria, Egjipti, Libia, Italia dhe Marok. Një rol mjaft të rëndësishëm në këtë webinar luajtën pikërisht prania e fëmijëve të grupmoshave të vogla (deri 12 vjeç) përfaqësues të vendeve të ndryshme të cilët ndajnë eksperiencën midis tyre dhe mësojnë të mirat që sjell rëndësia e peshkimit të qëndrueshëm si dhe konsumi i peshkut. Webinar i zhvillua brenda ambienteve të shkollës "Lef Sallata" me nxënësit e klasës së V.

Midis temave të ndryshme të

diskutuar, fëmijët panë mënyrën e të gatuarit të sardeleve si dhe u njohën me vlerat që konsumi i tyre sjell në rritjen e shëndetshme të fëmijëve si më poshtë:

Peshku shpesh quhet edhe "ushqimi për trurin". Shkaku është se peshku përmban shumë selen, mineral i cili dukshëm ngre përvetësimin. Hulumtimet kanë vërtetuar se edhe mungesa e vogël e selenit çrregullon asimilimin. Peshku duhet të merret rregullisht për shkak se është një burim i vlefshëm ushqyes. Peshku i detit është një furnizues i madh i materjes themelore - jodit, e cila është thelbësore për funksionimin e gjëndrës tiroide - edhe për foshnjat është jetike dhe e rëndësishme për zhvillimin e saj. Është burim i lartë i proteinave të vlefshme biologjike dhe acideve yndyrore omega-3. Salmoni, përmban



*Vijon në faqe 4*

*Vijon nga faqe 3*

shumë acide të vlefshme yndyrore omega-3, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e trurit dhe qelizat nervore. Acidet yndyrore omega-3 quhen gjithashtu acidet kryesore yndyrore dhe marrja e duhur nga fëmijët siguron rritjen e shëndetshme, si dhe me një sërë efektesh përfituese në trupin e njeriut i cili kontribuon në promovimin e shëndetit



dhe parandalimin e sëmundjeve kronike.

Rreziku në konsumin e peshkut qëndron në praninë e mineraleve të rënda. Nivelet më të larta të metaleve të rënda gjenden kryesisht në peshqit e mëdhenj (peshku shpatë, tuna etj.). Prandaj fëmijët e moshave të vogla duhet të konsumojnë peshq më të vegjël ose prodhime të tjera deti si sardelet etj.

## *Rritja e kapaciteteve lokale për lobim dhe advokaci për mbrojtjen dhe mirëmenaxhimin e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë*

3 Prill 2019 - Pranë ambjenteve të AdZM Elbasan startoi projekti "Rritja e kapaciteteve lokale për lobim dhe advokaci për mbrojtjen dhe mirëmenaxhimin e Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë" i cili zbatohet nga shoqatat "Agri-en" dhe "AlbNatyra" në kuadër të projektit Fuqizimi i OMSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri, projekt i financuar nga BE dhe që zbatohet nga INCA.



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

## Nga veprimtaritë e grupimit "Të mbrojmë lumenjtë"

HEC Kalivaç: Kompania zhvillon takimet paraprake me informacion "të cunguar"

++Organizatave mjedisore mbajnë qëndrim në lidhje me projektin e hidrocentralit të Kalivaçit në lumin Vjosa++  
**Tiranë, 8 prill 2019** - Kompania koncesionare e HEC Kalivaç AYEN - ALB sh.a dhe kompania konsulente për hartimin e VNM-së, Abkons, kanë zhvilluar 2 takime me OJF-të mjedisore, në Tiranë. Qëllimi i këtyre takimeve ishte prezantimi i projektit të hidrocentralit të Kalivaçit dhe hapat që kompania do të ndërmarre për të zbatuar këtë projekt. Në këto takime kompania Abkons kërkoi të realizonte dhe konsultime për ndikimet në mjedis të projektit.



Pjesëmarrëse në këto takime, organizatat EcoAlbania, REC, INCA, Ekolëvizja, EuroNatur, EDEN, ACEG, Milieucontact Shqipëri, Ilinia dhe ResPublica, u shprehën se, që prej lidhjes së kontratës koncesionare (dt. 08.06.2018), nuk është bërë publik asnjë informacion zyrtar në lidhje me këtë projekt. Edhe në këtë takim të dedikuar për OJF-të, pjesëmarrësve nuk iu është vënë në dispozicion asnjë dokument paraprak apo studim i realizuar nga kompania mbi të cilin mund të jepnin mendimet apo komentet e tyre.

Organizatave u shprehën se ky nuk mund të

konsiderohet konsultim me palët e interesuara dhe se ato kanë marrë pjesë në këtë takim, vetëm për të shprehur interesin për të ndjekur porcesin e realizimit të studimit të VNM-së që është një çështje kaq e rëndësishme për vlerësimin e projektit të hidrocentralit të Kalivaçit në lumin Vjosa.

Gjatë takimit, Kompania konsultuese deklaroi se studimi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social nuk ka filluar dhe planifikohet të realizohet për një periudhë 4-5 mujore. Kjo ngre një shqetësim shumë serioz lidhur me cilësinë VNM-së, si dokumenti më i rëndësishëm që shoqëron një projekt të tillë. Nga ekperiencia e ekspertëve kombëtar dhe ndërkombëtar, të angazhuar prej më shumë se 3 vitesh me studime në lumin Vjosa, ka rezultuar se për të marrë të dhëna serioze nevojitet më shumë kohë, duke konsideruar faktin se ekzistojnë shumë pak të dhëna shkencore për biodiversitetin apo transportin e sedimenteve në Vjosë.

Nga ana tjetër Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka përfshirë në konsultime për projektin asnjë nga grupet e interesit para se të nënshkruante kontratën për ndërtimin e hidrocentralit, duke vënë para faktit të kryer banorët, OJF-të, qeverisjen lokale, etj.

Vjosa është lumi i fundit i egër në Evropë që ende rrjedh i lirë. Ky rrjet lumor unik nuk gjendet më në Evropë dhe si i tillë përbën potencial të lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të gjithë luginës, përmes ekoturizmit dhe fuqizimit të ekonomisë lokale.



## *Gjiri i Porto Palermos të shpallet Zonë e Mbrojtur Detare*

U organizua në Himarë trajnimi i rrjetit të organizatave lokale dhe individëve të interesuar mbi advokacinë dhe lobimin për të kërkuar që Gjiri i Porto Palermos të shpallet Zonë e Mbrojtur Detare. Aktiviteti u organizua nga shoqata Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Naryror, Vlorë, në kuadër të projektit "Fugizimit të OMSHC-ve për të promovuar mbrotjen e natyrës në Shqipëri" projekt i financuar nga BE dhe që zbatohet nga INCA.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

## *Mbrojtja e Deltës së Bunës*



19 Prill 2019 - Në kuadër të projektit "Mbrojtja e deltës së Bunës" u zhvillua takimi midis aktoreve të projektit për diskutimin e procedurave të minigranteve që do të jepen nga projekti për komunitetin lokal për mirëmenaxhimin dhe mbrojtjen e zonës.

## *Furnizimi me energji fotovoltaike për tre qendrat e vizitorëve të parqeve kombëtare*

**Divjakë 19 prill 2019** - Në kuadër të projektit "Furnizimi me energji fotovoltaike për tre qendrat e vizitorëve të parqeve kombëtare", përfundoi instalimi i paneleve duellora në qendren e vizitoreve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

Ky projekt zbatohet nga INCA në kuadër të Programit të Granteve të Vogla financuar nga GEF. Panelet po instalohen nga kompania EuroElektra Sh.P.K.



## Zhvillimi i ekoturizmit të qëndrueshëm duke respektuar mjedisin

Divjakë 24 Prill 2019 - Në ambientet e Qendres së Vizitoreve në Parkun Kombëtar Divjake Karavasta u zhvillua një takim me aktorët dhe faktorët përfshirës në zbatimin e planit të menaxhimit të këtij parku.



Në kuadër të projektit "Fuqizimi i OMSHC-ve për të promovuar mbrotjen e natyrës në Shqipëri"- *Advokim për zhvillimin e ekoturizmit të qëndrueshëm duke respektuar mjedisin*" i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga INCA, dhe që zbatohet nga organizatat Horizont EU dhe Mireqeverisja e Ekosistemeve Natyrore (MEN), u organizua një takim me fokus mobilizimin dhe informimin e komunitetit të zonës dhe pushtetit lokal në funksion të zbatimit të planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjake -



Karavasta (PKDK) si dhe rolit dhe përgjegjësitë të tyre për promovimin e ekoturizmit të qëndrueshëm lokal me baze natyrore si një burim financiar i rëndësishëm në ekonomine vendase.

Në këtë takim krahas drejtuesve dhe përfaqësuesve të shoqatave Horizont EU dhe MEN ishin të pranishëm drejtori i AdZM qarku Fier, drejtues të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të Bashkisë Divjake, përfaqësues të mediave si dhe banorë të zonës së Divjakes.

Takimin e hapi drejtuesi i projektit dhe njëherazi dhe drejtuesi i shoqatës Horizont EU Shkelqim Bylykbashi i cili bëri një përmbledhje të rëndësive të këtij projekti për zonën e Divjakes për të rritur dhe përmirësuar sektorin e turizmit por njëherazi duke ruajtur natyrën e çmuar të Parkut Kombëtar Divjake Karavasta.



Ardian Koçi drejtori i AdZM Qarkut Fier nëpërmjet video projektorit njohu të pranishmit me rëndësinë e Planit të Menaxhimit të PKDK të përgatitur nëpërmjet një bashkëpunimi midis Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të tjera shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore kufi ose brenda zonës së parkut, si dhe aktorë të tjerë lokale që lidhen me Parkun dhe burimet e tij natyrore. Hartimi i Planit të Menaxhimit për Parkun Kombëtar Divjake-Karavasta është realizuar nëpërmjet Projektit për konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar Divjake-Karavasta, me pjesëmarrjen e qeverisjes vendore dhe palëve të interesuara", financuar nga JICA, 2012-2014.



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

## Ndikimi në politikat e ruajtjes së natyrës nëpërmjet advokim-lobimit efektiv

Tiranë - 25 Prill 2019 - Shqipëria ka një potencial dhe diversitet të lartë biologjik, por ajo po vuan dëme të mëdha të cilat në shumë raste janë të pakthyeshme.



Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Shqipëri ende nuk është integruar siç duhet në politikat kombëtare dhe lokale. Përfshirja e komuniteteve lokale dhe të OMSHC-ve në vendimmarrje dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe të zonave të mbrojtura është e pamjaftueshme. Kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikës së mjedisit dhe ruajtjes së natyrës dhe lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime të panevojshme.

Organizatave të Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMSHC) shihen sot si forca lëvizëse për transformimin e shoqërisë në kontekstin e një zhvillimi të qëndrueshëm sa me miqësor me mjedisin. Disa prej tyre kanë potenciale të mira për të zhvilluar dhe për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Megjithatë, për t'u përfshirë vërtet në hartimin e politikave të ruajtjes së natyrës, OMSHC-të duhet të rritin më tej kapacitetet dhe burimet e tyre.

Në këtë kuadër OMSHC-të duhet të luajnë një rol aktiv dhe efektiv në planifikimin dhe zbatimin e

masave të ruajtjes së natyrës dhe angazhimin e palëve të tjera të interesit për vendimmarrje koherente. OMSHC-të, duhet të formojnë një mesazh bindës mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës, të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore për politikë-bërësit, subjektet dhe komunitetin, por ne të gjithë mund të përfitojmë, duke mësuar nga përvojat e të tjerëve edhe nga mjetet që na ndihmojnë të mendojmë dhe veprojmë në mënyrë strategjike. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) kanë nisur zbatimin e projektit "Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri". Projekti financohet nga Komisioni Evropian në kuadër të programit "Mbështetje për kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile".



Grupet e synuara në këtë projekt përfshijnë (i) organizatat mjedisore të shoqërisë civile, (ii) autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e natyrës, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe menaxhimin e ZM-ve në të gjitha nivelet e qeverisjes, (iii) sektorin privat, komunitetet, ku janë vendosur ZM-të e synuara dhe v) mediat lokale dhe kombëtare.

*Vijon në faqe 9*





*Vijon nga faqe 8* Një nga elementet kryesor të projektit është edhe përgatitja e doracakut "Ndikimi në politikat e fushës së ruajtjes të natyrës nëpërmjet advokim-lobimit efektiv", i cili do t'i vijë në ndihmë OMSHC-ve me disa orientime dhe këshilla mbi praktikën më të mirë, për të ndikuar proceset vendimmarrëse, për çështjet e natyrës dhe mjedisit, në nivel kombëtar dhe lokal. OMSHC-të e përfshira në këtë projekt, përmes programeve të minigranteve, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuara, po ndërmarrin iniciativë, duke u përfshirë më mirë në proceset e advokimit, lobimit dhe reagimit ndaj problematikave të ruajtjes së natyrës e të biodiversitetit, në nivel lokal dhe kombëtar; duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe informimit të medias, anëtarëve të këshillave bashkiake, të komisioneve përkatëse lokale, rajonale dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Pa veprime të koordinuara ndërmjet OMSHC-ve, përpjekjet nuk do të marrin efektin e nevojshëm; prandaj bashkëpunimi i tyre është vendimtar. Një praktikë efektive për këto procese është që OMSHC-të duhet


të rrjetëzohen, të ndajnë informacione apo/dhe të formojnë koalicionë. Veprimi i bashkërenduar dhe



ndarja e punës është diçka që do të ndihmojë të mbulojë një gamë të gjerë aktivitetesh, si përgatitja e deklaratave me shkrim, takimi me institucionet përgjegjëse, iniciimi i peticioneve, organizimi i ngjarjeve mediatike, tubime, etj. Është një udhëzues specifik i ndërthurur mes instrumenteve të komunikimit, advokim, lobimit, adresimit e reagimit, nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese, për një pjesëmarrje më të gjerë



dhe aktive të përfaqësuesve të komuniteteve lokale, të forumevetë ndryshme vendimmarrëse, për të minimizuar problematikën dhe për të nxitur menaxhimin e përbashkët të burimeve dhe peizazhit natyror. Doracakun ndihmon me informacione dhe mjete relevante për të mundësuar që të zhvillohet e hartohet një Strategji të advokim-lobimit sa më efektive. Mjetet e parashtruara nxisin të mësuarit e OJF-ve dhe të partnerëve për të rritur përpjekjet e tyre për të advokuar e lobuar në një mjedis të përshtatshëm, për të rritur presionin mbi vendimmarrësit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e politikave të fushës së ruajtjes të natyrës, nga OSHC-të dhe nga ekspertët, të cilët kanë qenë të suksesshëm në advokim-lobim.



*Vijon në faqe 10*

Vijon nga faqe 9

Trajnimi Kombëtar "Ndikimi në politikat e ruajtjes së natyrës nëpërmjet advokim-lobimit efektiv", ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve për praktikatat më të mira të advokimit në fushën e ruajtjes së natyrës. Objekt i këtij trajnimi do të jetë njohja e OShC-ve, autoriteteve përgjegjëse për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore, në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe mediave, me doracakun "Ndikimi në politikat e



fushës së ruajtjes të natyrës nëpërmjet advokim-lobimit efektiv". Trajnimi shërben edhe si një tryezë komunikimi me OJF-të lokale për të diskutuar rreth rrjetëzimit të tyre, për hartimin e planit të advokim-lobimit, si dhe rritjes së rolit dhe fuqizimit të aftësive të OShC-ve, në zbatimin e legjislacionit, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe të zonave të mbrojtura.

Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

## Një copëz lagunë vjen në Tiranë / nga REC Shqipëri

Dhuratat e natyrës për planetin tonë janë miliona lloje. Për fat të keq, qeniet njerëzore kanë dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme ekuilibrat e natyrës dhe si rezultat, bota po përballlet me shkallën më të lartë të zhdukjeve të llojeve që prej kohës së dinosaurëve, më shumë se 60 milionë vite më parë. Por ndryshe nga fati i dinosaurëve, zhdukja e shpejtë e llojeve në botën tonë sot është rezultat i aktivitetit njerëzor. Ndryshimi i klimës tashmë është një realitet dhe sfidë për këdo që jeton në këtë planet.

Shkatërrimi global i paprecedent dhe zvogëlimi i shpejtë i popullsisë së bimëve dhe kafshëve të egra janë të lidhura drejtpërdrejt me shkaqet e nxitura nga aktiviteti njerëzor si: ndryshimi i klimës, shpyllëzimi, humbja e habitateve, trafikimi dhe gjuetia, bujqësia e paqëndrueshme, ndotja dhe pesticidet. Ndikimet janë shumë të mëdha, sidomos për ekosistemet më të brishta si ato të ligatinave dhe lagunave të cilat

"thërrasin" për reagime më të shpejta.

Të gjitha qeniet e gjalla kanë një vlerë të paçmueshme dhe secili organizëm luan një rol të veçantë në rrjetën e ndërlikuar të jetës. Ne duhet të punojmë së bashku për të mbrojtur llojet e rrezikuara dhe të kërcënuara: insektet, bletët, zogjtë, gjitarët, delfinët, fokat por dhe të gjithë tëtjerat.



Lajmi i mirë është se shkalla e zhdukjeve ende mund të ngadalësohet dhe shumë nga llojet tona në zhdukje, të kërcënuara dhe të rrezikuara mund të jenë përsëri të sigurta, nëse punojmë së bashku tani për të ngritur një lëvizje të përbashkëtbotërore të konsumatorëve, votuesve, mësuesve, udhëheqësve dhe shkencëtarëve për të kërkuar veprim të menjëhershëm.

22 Prilli festohet në të gjithë botën si Dita e Tokës, dhe në këtë ditë ajo që promovohet më shumë është kujdesi për planetin tonë. Tema e këtij viti ju bën thirrje të gjithë njerëzve të bashkohen me fushatën

Vijon në faqe 11

*Vijon nga faqe 10* për Mbrojtjen e Llojeve tona.

Në këtë kuadër REJA, si një nga sitet turistike më të vizituara të Tiranës mirëpriti ekspozitën e fotografive të Lagunës së Kune Vainit në kuadër të ditës së tokës por dhe fushatës së ndërgjegjësimit që po bëhet në nivel kombëtar në kuadër të Projektit "Ndërtimi dhe rikuperimi i lagunës së Kune-Vainit".

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja, përse në ditën e Tokës REC Shqipëri sjell



këtë Lagunë tek REJA në Tiranë?

Së pari Laguna e Kune Vainit është një lagunë që vizitohet jo shpesh nga qytetarët e Tiranës dhe e njohur prej tyre vetëm nga ekrani i televizorit për problematikën që ajo shfaq në lidhje me përparimin e detit drejt saj. Ardhja e lagunës nëpërmjet ekspozitës së fotove të llojeve apo peisazheve të saj kërkon të krijojë një marrëdhënie të qytetarëve me natyrën që do të duhet të përfshijë dhe vlerat e saj. Por njerëzit duhet ta mësojnë që Laguna e Kune Vainit është një ekosistem natyror-lagunor si dhe një nga lagunat më të rëndësishme të bregdetit shqiptar të Adriatikut. Ajo është zona e parë e mbrojtur në Shqipëri, e shpallur e tillë qysh prej 1940, prandaj vlerat e saj në këtë ditë

duhet të shpallen dhe më fort.

Ky ekosistem karakterizohet nga habitate të ndryshme të integruar në një ekosistem të vetëm. Shumëllojshmëria e habitateve dhe karakteristikat e tyre natyrore kanë krijuar kushtet e duhura për lloje përfaqësuese të biodiversitetit. Ndër gjallesat e egra, llojet me status të veçantë që konsiderohen globalisht të rrezikuara, janë karabullaku dhe lundërza që kanë gjetur shtëpi tek Kune Vaini. Duke parë foton e çafkës së vogël, njerëzit do të mësojnë që kjo lagunë është e vetmja zonë shumimi për të. Por laguna vizitohet herë pas here nga breshkat e detit dhe foka mesdhetare që kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për jetën e gjallë e larminë biologjike të vendit tonë por për të gjithë ekosistemin mesdhetar. Prandaj, në Ditën e Tokës është ndoshta momenti më i rëndësishëm për të organizuar aktivitete edukimi sepse rritja e vetëdijes për shkallën e përshpejtimit të zhdukjes së miliona llojeve dhe shkaqet dhe pasojat e këtij fenomeni



grupet e gjera të llojeve, si dhe llojet individuale dhe habitatet e tyre.

kërkon që të punojmë të gjithë së bashku në arritjen e politikave kryesore që mbrojnë

## ***Dita e Tokës 22 dhe 23 Prill 2019 / nga Qendra EDEN***

Qendra Mjedisore EDEN, sikundër çdo pranverë të viteve të kaluara, zhvilloi festimin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës edhe këtë pranverë! Kthyer në një traditë të organizatës e cila këtë ditë kaq të rëndësishme e lidh me sitën e bukur të pranverës, çeljen e luleve, ardhjen e zogjve shtegtarë pra zgjimin e natyrës nga dimri i gjatë. Jo rastësisht kjo Ditë gjithmonë sjell dëshirën për të punuar akoma më shumë dhe për të sjellë ndryshim në sjelljen e njeriut përkarshi tokës sepse kjo stinë të kujton se çfarë mrekullish ka kjo tokë të cilat janë shumë të brishta kundrejt aktiviteteve njerzore.

Dita e Tokës këtë vit u organizua në datë 22 dhe datë 23 Prill 2019.

**Ditën e hënë 22 Prill**, të rinjtë aktivë dhe shumë të dashur të EDEN organizuan një panair "up-cycling" me materiale të ricikluara përpara Qendrës Ekologjike të Edukimit Mjedisor EDEN në Kopshtin Zoologjik të Tiranës. Materialet të punuar me aq mjeshtëri përcillnin mesazhin që kjo ditë mbarte "Të Mbrojmë Speciet". Të rinjtë e angazhuar në këtë aktivitet infomuan të gjithë vizitorët që kalonin aty pranë për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe efektet ngative që sjell aktiviteti njerzor te gjallesat

*Vijon në faqe 12*

Vijon nga faqe 11 e tokës dhe te ujit.  
**Ditën e martë datë 23 prill 2019**, pranë Parkut të Piramidës , Qendra EDEN dhe Bashkia e Tiranës festuan Ditën e Tokës duke promovuar nismën "BAS Për Tiranën Time". Kjo fest u zhvillua pikërisht në këtë



zonë me qëllim lançimin e projektit pilot në kuadër të projektit "Benefit As you Save -"BAS", Stimulimi i pjesëmarrjes qytetare në procesin e riciklimit përmes zbatimit të sistemit të përfitimit" pjesë e Programit Rajonal Interreg V-B " Ballkan-Mesdhe 2014-2020. Qëllimi i kësaj skeme është informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut për produktet miqësore me mjedisin si dhe ndarjen e mbeturinave që në burim. Për këtë ditë, organizuesit kishin zgjedhur specifikisht 3 tema : menaxhimin e mbetjeve, ujin si dhe energjinë, tema të cilat kanë lidhje direkte me ndërhyrjen e njerëzve në natyrë dhe keq përdorimi tyre sjell pasoja të mëdha në natyrë duke prekur specie e ndryshme.

Për të patur një ndikim të madh në zonën ku do të zhvillohet projekti pilot, por duke përfshirë dhe një një publik më të gjerë u zhvilluan një sër aktivitetesh. Festimi u hap me fjalimet përshëndetëse të **Znj. Ermelinda Mahmutaj**, Drejtore Ekzekutive qendra EDEN, duke vijuar me **Z. Genci Kojdheli**, Drejtor i Përgjithshëm i Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik Bashkia Tiranë. Magjinë e festimit si çdo vit e kishin punimet e bukura të krijuara nga duart e fëmijëve të shkollave 9-vjeçare: *Kosova, New York, Jordan Misja* dhe *Kolegji Turgut Oza*. Fëmijët kishin sjellë punimet e tyre me temë mbi reduktimin e mbetjeve, riciklimin dhe energjinë e rinovueshme. Për të përforcuar mesazhet e tyre, nxënësit e shkollës Kosova zhvilluan një pjesë teatrale me mesazhin që

njerzitet duhet të ndajnë mbetjet në burim dhe duhet të mos prodhojnë më mbetje pafundësisht, e më pas nxënësit e shkollës 9-vjeçare New York përcollën të njëjtin mesazh në formën e një skeçi duke bërë të gjithë pjesëmarrësit të buzëqeshin. Gjallërisë fëmimore dhe dëshirës për të ndryshuar realitetin ku jetojnë ju shtuan dy lojra aq të dashura dhe gazmore si: pikturimi i çantave prej beze duke shkruar mesazhe nga vetë fëmijët si dhe loja "Eko-Monopoli" që tërhoqi vëmendjen jo vetëm të fëmijëve, por dhe të rriturve që merrnin pjesë në këtë aktivitet.

Të fokusuar në përcjelljen e mesazheve, në hapësirën ku zhvillohej aktiviteti ishin ekspozuar panele foltovoltaike nga kompanitë e energjisë diellore dhe githashtu një ekspozitë fotografish për mbrojtjen e mjedisit. Në kënd shumë i veçant ishte "Këndi i Ditës së Tokës Ndër Vite", një kënd që solli në vëmendje të gjitha festimet e mëparshme dhe temat që ka përcjell çdo vit kjo festë. Kjo ditë kaq e veçantë dhe me kaq



shumë festime u mbyll me përshëndetjen e **Z. Blendi Klosi**, Ministër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i cili me shumë entuziazëm dhe vëmendje ndoqi prezantimin e fëmijëve për të gjitha punimet e krijuara nga duart e tyre.

Fëmijët, e ardhmja e vendit tonë treguan sërish që pranvera është stina e zemrës së tyre sepse pranvera sjell jetë dhe jeta sjell ndryshim. *Të mbrojmë specie duke i dhuruar Tokës asgjë më shumë se vetëm dashuri duke ndryshuar sjelljen tonë.* Fotografitë e aktivitetit mund ti ndiqni në [facebook të qendrës EDEN](https://www.facebook.com/pg/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album_id=10156804570777561). [https://www.facebook.com/pg/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album\\_id=10156804570777561](https://www.facebook.com/pg/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album_id=10156804570777561)

**Jonida Hafizi-Qendra EDEN**

## Ekonomia e gjelbër / nga Qendra EDEN

Vizitë studimore mbi Ekonominë e Gjelbër në një nga qytetet më të gjelbra, Osijek-Kroaci

Më 1 Mars 2018, Qendra EDEN filloi me zbatimin e një projekti të ri "[GEAR - Ekonomia e Gjelbër për një Zhvillim Rajonal](#)" me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe ndikimit të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, në mbrojtje të mjedisit përmes rrjeteve, duke forcuar kapacitetet e tyre dhe duke promovuar ekonominë e gjelbër. Deri më tani janë zhvilluar tre trajnime në Shqipëri me tematikat e Ekonomisë së Gjelbër, Advokimit dhe Lobimit Publik dhe Menaxhimit të Ciklit të Projektit.

Faza tjetër e projektit trevjeçar ishte një vizitë studimore mbi Ekonominë e Gjelbër më 13-17 prill 2019, në një nga qytetet më të gjelbra Osijek, Kroaci. Në këtë vizitë studimore morën pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia Veriore, Mali i Zi dhe Serbia, partnerë të këtij projekti.

Shqipëria u përfaqësua nga 6 pjesëmarrës që punojnë në fushën e mjedisit të shoqërisë civile, në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe në interes të ekonomisë së gjelbër. Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë disa praktika të sipërmarrjes së gjelbër, si shtëpitë dhe shkollat e gjelbërta, qendrat eko, kompanitë e riciklimit, panelet diellore etj. Të gjithë këta shembuj tërhoqën vëmendjen e pjesëmarrësve pasi ishin shumë kurioz dhe drejtuan shumë pyetje konstruktive.

Kjo përvojë i mbushi me ide të reja, që mezi prisnin të zbatonin në qytetet dhe në organizatat që ata përfaqësonin me komunitetin lokal.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Mbështetjes së Shoqërisë Civile dhe Medias 2016-2017 dhe aktivitetet pasardhës do të jenë tre trajnime në Maqedoni.

"Deri atëherë, do ju mbajmë në kontakt! J Na ndiqni në faqen tonë në [Facebook!](#)

Qendra EDEN!

## Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



**Shteti:** Bosnja dhe Hercegovina

**Rasti:** OJQ vendore kundër manipulimit të ligjit.

**Theksi:** Ndryshime të rëndësishme në krijimin e projektit kërkojnë procese të reja vendimmarrjeje.

Një kompanie në Republikën e Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë (BiH) iu dha një koncesion për të ndërtuar hidrocentralin 'Lomska' me kapacitet të instaluar prej 0,22 megavatësh (MW). Ky koncesion bazohej në dokumente të plota mbështetëse, duke përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Megjithatë, pas dhënies së koncesionit zhvilluesi dhe Ministria kompetente ranë dakord për një aneks në kontratën e koncesionit, sipas të cilit kapaciteti i instaluar u rrit në 4,8 MW (22 herë më i lartë se kapaciteti i instaluar që ishte miratuar fillimisht). Më pas u dha një leje mjedisi lidhur me kapacitetin e instaluar, pavarësisht se ndikimi në mjedis i kapacitetit nuk ishte vlerësuar.

Një OJQ vendore ngriti padi kundër Ministrisë kompetente ku kërkonte anulimin e lejes së mjedisit. Në padi thuhej që dokumentet origjinale, duke përfshirë edhe VNM-në dhe veprime të tjera, ishin ndërmarrë për një kapacitet të instaluar që është shumë më i ulët.

Gjykata e pranoi padinë dhe anuloi lejen. Ajo gjithashtu i kërkoi Ministrisë të përshtaste të gjitha dokumentet procedurale për të reflektuar në situatën e vërtetë në terren.

Megjithatë, Ministria përkatëse bëri një kërkesë të Gjykata e Lartë e Republikës së Srpska për shqyrtimin *ex officio* të vendimit të gjykatës. Ky proces është në zhvillim. Në të njëjtën kohë, Ministria dha një leje të re mjedisore të bazuar në kërkesën e parë, duke mos e marrë parasysh vendimin e Gjykatës.

Me mbështetjen e Aarhus CenterBanja Luka, shoqata vendore ngriti një padi kundër Ministrisë për të dhënë një leje të re dhe ky proces është ende në zhvillim.

## ...me këtë rast Ju kujtojmë se

### ...1 vit më parë ...

**VKM nr. 354, datë 2.5.2018 "PËR ZGJERIMIN DHE KTHIMIN E PARKUT RAJONAL "ZAGORI" NË PARK NATYROR".**

Sipas këtij vendimi në territorin e parkut natyror perfshihet dhe MN "Zhej", me sipërfaqe 1,500.0ha, i miratuar me VKM nr.102, datë 15.1.1996, si dhe pjesa e

Lumit Vjosë, nga fillimi i Grykës së Këlcyrës deri te bashkimi me Lumin Drino.

### 2 vjet më parë ...

**...aprovohet Ligji nr.81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"**

**Objekti dhe fusha e zbatimit:** Ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizik/juridik privat për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre nëpërmjet: a. evidentimit, përcaktimit dhe shtimit të zonave të mbrojtura ose zgjerimit të atyre ekzistuese; b. sigurimit, ruajtjes, rehabilitimit dhe ripërtëritjes së ekosistemeve të habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore brenda zonave të mbrojtura; c.përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, duke integruar elementë të tij në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

**Qëllimi:** Të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet: a) shpalljes të zonave të mbrojtura, me rëndësi të veçante për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; b) zhvillimit dhe mbrojtjes së zonave të mbrojtura, pasuri kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit si detyrim në interes të brezave të sotmëm dhe të ardhshëm; c) lehtësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm

dhe promovimin e vlerësimit e shërbimeve ekosistemit (mjedisore); d) informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura.

Në dispozitat e këtij ligji janë përcaktuar, për herë me këtë ligj, edhe parimet për menxhimin dhe ruajtjen e ZM, sipas: a. *Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm*; b. *Parimi i integritetit*; c. *Parimi "ndotësi paguar"*; d. *Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake*.

Nëkëtëligjka disa rregullime dhe saktësime nga ligji i mëparshëm. Flitet për sistemin kombëtar të ZM; Llojet dhe kategoritë e ZMM, Zonat e mbrojtura detare, Parqet natyror bashkiak, Kurorat e gjelbërta, Zonat e mbrojtura ndërkombehtar, Zonat e mbrojtura me interes ndërkombëtar; Zonat Ramsar dhe IBA; Rezervatet e biosferës; Mbi pronësinë dhe format e qeverisjes së tyre; Objektivat, kriteret, procedurat e shpalljes dhe të zonimit të territorit të një ZMM; Zonat e veçanta të ruajtjes së rrjetit ekologjik të zonave me interes për komunitetin evropian, kriteret e vlerësimit dhe të shpalljes së tyre; Objektivat dhe elementët e rrjetit ekologjik dhe të zhvillimit, planifikimit, bashkërendimit dhe drejtimit të tyre; Veprimtaritë ekonomike në ZMM; Strukturat e menaxhimit të ZMM; Planet e menaxhimit; Zonimi i territorit të ZMM; Pronësia dhe të drejtat në ZMM; Menaxhimi financiar; Pjesëmarrja e publikut, informimi, monitorimi dhe kërkimi; Inspektimi dhe sanksionet.

**Ky ligj zevëndësoi Ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 «Për zonat e mbrojtura».**

**Direktiva 92/43/EEC e21 Majit 1992 "Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër, të ndryshuar nga Direktiva 97/62/EC, Direktiva**

## 11 vjet më parë ...

...me VKM nr. 640, datë 21.05.2008, ekosistemit natyror malor i Shebenik-Jabllanicës shpallet "Park Kombëtar", me një sipërfaqe të përgjithshme prej 33,927.7 ha. PK shtrihet kryesisht në bashkitë e Librazhit dhe në atë të Bulqizës.

Për këtë park kombëtar është zhvilluar dhe projekti "Mbështetje institucionale për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në zonat e mbrojtura dhe menaxhimin e mbetjeve", që u financua nga Qeveria Italiane dhe u zbatua nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

## 14 vjet më parë ...

...Ligji "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", nr.9385, datë 04.05.2005, të ndryshuar.

Objekti: 1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, organeve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse, pronarëve privatë dhe të biznesit, për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre. 2. Ky ligj rregullon edhe veprimtaritë mbrojtëse, shoqërore, ekoturistike dhe ekonomike që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar dhe në burimet e tjera

Në Sesionine 41-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore (9-12 Korrik 2017) i mbledhur në Krakovë - Poloni, u miratua zgjerimi i zonës së Trashëgimisë Botërore të pyjeve të vjetër të Ahut (Fagussylvatica, L.) edhe me dy zona nga Shqipëria, duke i përfshirë ato në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Bëhet fjalë për zonën e Lumit të Gashit (pjesë e Rezervës Strikt Natyrore), e cila menaxhohet nga Administrata e Zonave të Mbrojtura, qarku Kukës dhe zonën e Rrajcës (pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë), e cila menaxhohet nga Administrata e Zonave të Mbrojtura, qarku Elbasan.

pyjore e jopyjore, në bazë të parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumëfunksional, të pasqyruara në strategjinë dhe politikat e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, si dhe skemën e organizimit e të funksionimit të administratës së Shërbimit Pyjor Shqiptar, marrëdhëniet juridike, përgjegjësitë dhe detyrat e tij, për krijimin e një shërbimi pyjor të qëndrueshëm dhe profesional.

Nuk janë objekt i këtij ligji zonat e mbrojtura, fauna e egër, si dhe bimët mjekësore eterovajore e taniferenatyrore, të cilat rregullohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi".

## 4 vjet më parë ...

Me urdhërin e ministrit të Mjedisit nr.1792, datë 09.05.2015 miratohet Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar "Prespa".

## 7 vjet më parë ...

... miratohet Ligji Nr. 64, dt 31.05.2012 "PËR PESHKIMIN"

Ky ligj rregullon veprimtarinë e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, rregullon marrëdhëniet që lindin dhe lidhen me siguri në ushqimore të produkteve të peshkimit, mbrojtjen e konsumatorit dhe sëmundjet e peshqve, të cilat rregullohen me ligje të veçanta.

Ky ligj ka për qëllim:

- sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të

ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare;

- përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes;
- përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme;
- nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim;
- sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit;
- hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e

sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit;

- përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat evropiane në këtë drejtim;
- ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e treg.

### ...5 vjet më parë ...

**VKM nr.272, datë 07.05.2014** "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrave të shpëtimit të llojeve të faunës së egër".

### *Pelikani kaçurrel dhe rreziqet që i kanosen*

Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) është një nga llojet më të mëdhenj në grupin e shpendëve ujorë, të cilët gjenden kryesisht në zonën e lagunës së Divjakë-Karavastasë (ishulli i pelikanit) e cila është zona më e rëndësishme për folezimin e tyre. Por ai është i pranishëm edhe në zona të tjera ujore siç është laguna e Nartës, liqeni i Prespës etj. Në zonën e lagunës së Nartës, sipas vëzhgimeve të bëra kohëve të fundit, ata janë vënë re në grupe të vogla të cilët e përdorin këtë lagunë si një zonë ushqimi.

Gjatë ditëve të fundit është vënë re një individ i ngordhur i kësaj specie, shkak i të cilit mendohet të jetë përplasja me shtyllat elektrike. Një nga problemet më të mëdha që hasin shpendët e përmasave të mëdha në të gjithë botën rezultojnë të jenë pikërisht shtyllat elektrike. Shqipëria është një nga vendet të cilat hasin problem të mëdha me mënyrat e menaxhimit dhe izolimit të shtyllave elektrike mjaft të rrezikshme jo vetëm për njeriun,

por edhe për një numër të konsiderueshëm të specieve të tjera, si shpendët.





## Kuriozitete për Peshkaqenët

Peshkaqeni balenë (Rhincodontypus) është peshkaqeni që arrin dimensioned më të mëdha (deri në 20 metra dhe 42 ton) dhe gjithashtu peshqit më të mëdhenj që jetojnë në botë. Kjo specie ushqehet me plankton dhe peshq të vegjël dhe është në gjendje të zhytet deri në të paktën 1,928 m thellësi.



Llojet më të vogla të peshkaqenit janë peshkaqenët xhuxhë (Etmopterus perryi), meshkujt arrijnë një gjatësi maksimale prej 17 cm, femra nuk kalon 20 cm. Është vërejtur në habitatin e tij, në Detin e Karaibeve në brigjet e Venezuelës dhe Kolumbisë, në thellësi që variojnë nga rreth 250 deri në 450 metra.

## Njoftime

- 10 Maj - Dita Kombëtare e Pelikanit
- 11 Maj - Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë (e shtuna e dytë e majit)
- 21 Maj - Dita Europiane e Rrjetit Natura2000 / Dita Botërore e Peshqve Shtegtarë
- 22 Maj - Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit
- 23 Maj - Dita Botërore e Breshkave
- 24 Maj - Dita Europiane e Parqeve
- 31 Maj - Dita Botërore Kundër Duhanit
- 1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

## Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



## Organizatat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
 Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro